



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_358_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_557_03_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_557_03_11**;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET ankesa e konsumatorit Ismet Veliu, Fast Food "Mediteran" (shifra e konsumatorit DPR – 2001825) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 04.12.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 16.10.2008 lidhur me kontestimin e bartjes së borxhit nga shifra DPR – 90010271 në shifrën DPR -2001825 për faturat e muajit 09/1999 dhe 10/1999.

- Me datë 30.09.1999 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike me 2890 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 176.868 €.
Provë: Fatura e muajit 09/1999
- Me datë 31.10.1999 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike me 90 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 5.508 €.
Provë: Fatura e muajit 10/1999
- Me datë 13.02.2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se konsumatori ka vendosur për matje njehsorin e ri elektrik nr. 43807043.
Provë: Lista e leximit periudha 02/2007 dhe 03/2007
- Me datë 09.03.2007 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR07HP02373 në vlerë prej 200.82 € dhe i ka hapur konsumatorit shifër te re DPR (IL)2001825.
Provë: Fatura DPR07HP02373 e datës 09.03.2007
- Me datë 09.07.2007 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për ndërrim njehsori.
Provë: Aplikacioni për zëvendësim-kalibrim të njehsorit të datës 09.10.2007



- konsumatori dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të njehsorit elektrik nr. 43807043 të vendosur nga vet konsumatori si dhe kanë konstatuar se njehsori i vjetër elektrik nr. 398560 nuk ekziston pasi që i njëjti është djegur bashkë me lokal.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0389 i datës 10.07.2007
- Me datë 12.11.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikës matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë vërtetuar të dhënat teknike të njehsorit elektrik si dhe kanë konstatuar se konsumatorit i është hapur shifër e dyfishtë DPR - 2001825 pasi që konsumatori ka pasur më herët të hapur shifër DPR - 90010271 të cilat duhet të bashkohen dhe se konsumatorit nuk është dashur ti hapet shifër e re.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 022806 i datës 12.11.2007
- Me datë 08.12.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikës matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se njehsori elektrik është i vulosur si dhe teknikisht në rregull.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 019171 datë 08.12.2007
- Me datë 14.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikës matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë konstatuar se njehsori elektrik është teknikisht në rregull por që konsumatori faturohet në shifrën IL DPR - 2001825 e që duhet të faturohet në shifrën DPR 90010271, dhe kanë konstatuar se shifra IL DPR - 2001825 duhet të pasivizohet ndërsa shifra aktive duhet të jetë DPR - 90010271.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0144519 datë 14.04.2008
- Me datë 2.05.2008 KEK-u ka bërë korigjimin e faturave deri në periudhën 04.11.2002 në shifrën DPR - 90010271 si dhe ka transferuar borxhin e mbetur në vlerë 182.38 € nga shifra DPR – 90010271 në shifrën DPR - 2001825 përmes urdhër lejimit/ngarkimit nr. 16355.
Provë: Urdhër lejimi/ngarkimi nr. 16355 i datës 12.05.2008
- Me datë 09.09.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit 09/1999 dhe muajit 10/1999.
Provë: Ankesa e konsumatorit
- Me datë 16.10.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në transferin e borxhit nga shifra DPR - 90010271 në shifrën DPR - 2001825.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 16.10.2008
- Me datë 04.12.2008, konsumatori ka apeluar përgjigjur e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ KEK-u për llogaritjen e faturës se muajit shtator 1999 dhe tetor 1999 konsideron se ka marrë për bazë gjendjen reale të kilovatëve të shpenzuar e që janë të faktuara (lexuar në njësor) në rrjedhën e energjisë aktive.
- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se kundërshton faturën e muajit shtator 1999 dhe tetor 1999 ngase nuk ka bërë atë shpenzim të energjisë elektrike. Konsumatori deklaron se nuk ka pasur mundësi të ketë bërë shpenzim të tillë të energjisë pasi lokali ka qenë i



djegur. Në deklaratën e konsumatorit theksohet se për periudhën të cilën e ngarkon KEK-u lokali ka qenë i djegur. Konsumatori po ashtu në ankesën e tij ka theksuar se të gjitha obligimet ndaj KEK-u i ka përfunduar dhe se nuk ka asnjë borxh ndaj KEK-ut

Provë: Deklarata e konsumatorit

- ✓ DMK ka kërkuar nga KEK-u që të ofroj argumente me të cilat do të vërtetohej se konsumatori i është bërë leximi si dhe faturimi i kWh të harxhuar për atë periudhë, por që KEK-u ka dështuar të bëjë një gjë të tillë duke mos ofruar të dhënat e kërkuara nga DMK.
- ✓ Konsumatori ka ofruar shkrimin e kohës ditore datë 23.10.1999 ku përshkruhet rasti i ndodhur përkatësisht jepen fakte mbi djegien e dy lokaleve në qendrën e Prishtinës në natën e 22.10.1999 më ç'rast dy lokale ishin djegur plotësisht ku njeri lokal ishte pronë e konsumatorit Ismet Veliu.
Provë: Shkrimi në koha ditore e datës 23.10.1999
- ✓ Bazuar në analizën e listave të leximit konstatohet se lexuesi i KEK-ut me datë 13.02.2007 ka identifikuar se konsumatori ka vendosur njehsorin elektrik me nr. 43807043 si dhe ka regjistruar shpenzimet e regjistruara të energjisë elektrike (TL=653 kWh dhe TU=1076 kWh) dhe ka konstatuar se njehsori elektrik është i pa vulosur.
Provë: Lista e leximit periudha 02/2007
- ✓ Me datë 09.03.2007 bazuar në listën e leximit KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR07HP02373 në vlerë prej 200.82 € dhe ka hapur shifër të re DPR (IL) 2001825 konsumatorit për derisa konsumatori ka pasur shifrën DPR 90010271.
- ✓ Bazuar në procesverbalet e ofruara nga KEK-u si dhe listat e leximit konstatohet se konsumatori ka bërë vet vendosjen e njehsorit të ri nr. 43807043 duke mos bërë kërkesë zyrtare pranë KEK-ut për ndërrim të njehsorit por që një gjë të tillë e ka bërë vetëm me datë 09.07.2007 e që është në kundërshtim me nenin 4 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.
- ✓ KEK sha me rastin e identifikimit nga lexuesi në muajin 02/2007 dhe përpilimit të faturës së rikthimit të humbjeve nuk është dashur që ti hap shifër të re konsumatorit, por që është dashur që aktivizoj shifrën e vjetër DPR – 90010271 dhe të vazhdoj faturimin në të njëjtën shifër.
Provë: Fatura e rikthimit të humbjeve DPR07HP02373
- ✓ Me datë 12.05.2008 KEK-u ka bërë korrigjimin e faturave në shifrën DPR - 90010271 deri në periudhën 04.11.2002 në vlerë 2,078.31€, ndërsa pjesën e borxhit prej 182.38 të mbetur në shifrën DPR – 90010271, ka transferuar në shifrën DPR – 2001825 përmes urdhër lejimit / ngarkimit nr. 16355.
Provë: Transaksionet e konsumatorit dhe urdhër lejimi/ngarkimi nr. 16355 i datës 12.05.2008
- ✓ KEK-u edhe përkundër që në vërtetimin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit nr. 0389 të datës 10.07.2007 ka dalë te konsumatori dhe ka konstatuar se njehsori paraprak nuk ekziston, është bërë ndërrim njehsori, njehsori i vjetër nr. 43807043 nuk ekziston, është i djegur me gjithë lokal dhe kanë marrë të dhënat e njehsorit të ri nr. 43807043. Punëtorët e KEK-ut vërtetimin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik e kanë përpiluar në shifrën DPR – 90010271, sipas aplikacionit për ndërrim njehsori. Në procesverbalet e KEK-ut nr. 022806,



nr. 019171 dhe nr. 0144519 vërehet se KEK-u i ka hapur shifër të re konsumatorit DPR – 2001825 dhe se konsumatori ka paguar të gjitha shpenzimet e bëra në atë shifër. KEK-u mbas 9 viteve ka bërë një bartje të borxhit nga shifra DPR – 90010271 në shifrën DPR – 2001825 për dy fatura 09/1999 dhe 10/1999. Sipas dokumenteve vërehet se KEK-u ka nuk ka siguruar argumentet se si janë lexuar dhe faturuar shpenzimi.

DMK, duke u bazuar në analizat dhe argumentet e paraqitura më lartë, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së, që të **aprovtojë** ankesën e konsumatorit dhe të obligojë KEK-un që të:

1. Shkarkojë shifrën e konsumatorit DPR – 2001825 nga korrigjimi nr. 16355 (urdhër lejimi / ngarkimi) i datës 12.05.2008 në vlerë prej 182.38 €.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovtojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Shkarkojë shifrën e konsumatorit DPR – 2001825 nga korrigjimi nr. 16355 (urdhër lejimi / ngarkimi) i datës 12.05.2008 në vlerë prej 182.38 €.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar